

**AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI I SHOQËRISË
“ALE INVESTA” SHPK.**

THEMELIMI

**Neni 1
Ortaku themelues**

- 1.1 Shoqëria “**ALE ADVISERS**” Shpk, shoqëri të drejtës shqiptare, e regjistruar në Regjistrin Tregtar me NUIS L71919026U dhe me adresë Rr. “Ibrahim Rugova”, P.64, H.8, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori dhe Ortaku i Vetëm i saj Elton Gjipali, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i identifikuar përmes kartës së identitetit me nr. H30830028J, themelon sot, më datë 07.08.2022, shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emrin “**ALE INVESTA**” Shpk.
- 1.2 Shoqëria “**ALE ADVISERS**” Shpk është Ortak i Vetëm i “**ALE INVESTA**” Shpk

EMËRTIMI, FORMA LIGJORE, SELIA

**Neni 2
Emërtimi**

- 2.1 Emërtimi i shoqërisë është: “**ALE INVESTA**” Shpk (në vijim Shoqëria)

**Neni 3
Forma ligjore**

- 3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**Neni 4
Baza ligjore**

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.

Neni 5

Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1 Veprimtaria e shoqërisë do të fillojë me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (“QKB”).
- 5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është i pacaktuar.

Neni 6

Selia

- 6.1 Selia shoqërisë është në adresën: Rr. “Ibrahim Rugova”, P.64, H.8.
- 6.2 Shoqëria mund të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.
- 6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen në Shqipëri.

Neni 7

Emblema. Vula

- 7.1 Shoqëria do të ketë emblemen dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.
- 7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar.
- 7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përmbajnë emblemen dhe vulën e saj.

Neni 8

Objekti

- 8.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është investimi në fushën e pasurive të paluajtshme, menaxhimi, shit/blerja, dhënia me qira, ndërtim dhe rikonstruksion i pronave residenciale dhe tregtare, brenda dhe jashtë vendit, si dhe cdo veprim tjetër të ligjshëm që ka të bëjë me pasuritë e paluajtshme. Veprimtari ekonomike në fushën e turizmit, operimit dhe administrimit të strukturave turistike pritëse,

- dhe gjithë shërbimet direkte që lidhen me to. Administrimi i pronësisë në ndërtesa, resorte turistike dhe komplekse residenciale. Tregtim me shumicë dhe pakicë i materialeve të ndërtimit të të gjitha llojeve dhe transportimit të tyre në funksion të ndërtimit, konstruksionit, menaxhimit të pasurive të paluajtshme. Mobilim të objekteve të ndryshme residenciale, hotele, zyra etj. Shoqëria mund të kryejë transaksione financiare lidhur me pasuritë e paluajtshme si dhe të garantojë detyrimet e veta apo palëve të treta duke vendosur mbi pasuritë e saj garanci të ndryshme sipas ligjeve në fuqi.
- 8.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Ortakut të Vetëm.

Neni 9

Kapitali

- 9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 2.000.000 (dy milion) Lekë.
- 9.2 Ortaku i Vetëm zotëron 1 (një) kuotë e cila është është e barabartë me kapitalin e shoqërisë.
- 9.3 Pjesët e kapitalit zotërohen 100% nga Ortaku i Vetëm.
- 9.4 Derdhja e Kapitalit do të kryhet pas regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar, gjatë fazës së zhvillimit të aktivitetit.

Neni 10

Transferimi i pjesëve të kapitalit. Kufizimet.

- 10.1 Pjesët e kapitalit mund të transferohen vetëm me akt noterial të shkruar.
- 10.1.1 Transferimi i pjesëve të kapitalit tek një palë e tretë bëhet me Vendimin e Ortakut të vetëm.
- 10.2 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi pjesët e kapitalit në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e asamblese se ortakëve.

Neni 11

Rritja e kapitalit

- 11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Ortakut të Vetëm.

- 11.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Ortakut të Vetëm.

Neni 12

Zvogëlimi i kapitalit

- 12.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.
- 12.2 Propozimi i zvogëlimit do t'i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përpara marrjes së vendimit nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë. Eksperti kontabël dhe administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do t'i paraqesin ortakut të vetëm raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.
- 12.3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë.

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 13

Vendimet e Ortakut të Vetëm

- 13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren nga Ortaku i Vetëm i saj.
- 13.2 Vendimet e Ortakut të Vetëm përfshijnë kryesisht:
- ndryshimin e selisë dhe të emërimit të shoqërisë;
 - rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
 - shitjen ose transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar palëve të treta;
 - prishjen dhe likuidimin e shoqërisë;
 - emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë;
 - miratimin e bilancit të shoqërisë;
 - transformimin e shoqërisë në forma të tjera.

Neni 14

Administrimi

- 14.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose një grup administratorësh që caktohen me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 14.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe drejtojë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Ortakut të Vetëm.
- 14.3 Administratori i shoqërisë është Z. Elton Gjipali, shtetas shqiptar, lindur më 30.08.1973, në Tiranë, banues në adresën “Blv. Gjergj Fishta”, Nd.6, H.3 A.7 Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me numër personal H30830028J.
- 14.4 Administratori është përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:
- drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
 - përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose me përfaqësim;
 - hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit;
 - emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar, në qoftë se është e nevojshme;
 - përgatitjen e dokumentave në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zotëron;
 - zhvillojnë veprimtari të tjera të cdo lloj natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj.
 - Administratori ka të drejtë për ta përfaqësuar shoqërinë në Shqipëri tek palët e treta, insitucione apo entitete publike ose private,
 - të lidhë kontrata për dhe në emër të shoqërisë me palë të treta, të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm për mbarëvajtjen e biznesit në Shqipëri,
 - të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri përpara bankave të nivelit të dytë dhe Bankës së Shqipërisë si dhe të kryejë cdo transaksion bankar në emër të shoqërisë,
 - të ndërmarrë cdo veprimtari tjetër ose biznes ose aktivitet i cili konsiderohet i nevojshme për biznesin e shoqërisë në Shqipëri.
- 14.5 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për pesë vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në castin e revokimit të tij me vendim të Ortakut të Vetëm.

Neni 15

Viti financiar

- 15.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 15.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyrën e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor 2022.

Neni 16

Bilanci. Kontabiliteti.

- 16.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Ortaku i Vetëm dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.
- 16.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit përkates. Për operacione të vecanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të vecanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.
- 16.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm.

Neni 17

Të ardhurat. Dividenti

- 17.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e qëllimeve të biznesit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 17.2 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, mund të ndahen ndërmjet ortakëve në raport me pjesët që ata zoterojnë në kapitalin e shoqërisë.
- 17.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe cdo ortak do të përgjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit të parë deri në tre ushtrimorët vijues.

Neni 18

Likuidimi

- 18.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin e Kuotambajtësve që pëfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$ kuotave të Shoqërisë.
- 18.2 Me vendimin e Ortakut të Vetëm caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh që do të plotësojnë procedurat e likuidimit.
- 18.3 Likuidatori do të përgatisë raportin e likuidimit mbi gjëndjen ekonomike të shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet për përfundimin e tij. Në përfundim të kësaj procedure, Ortaku i Vetëm do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe do të miratojë përfundimin e procedurave të likuidimit.

Neni 19

Mosmarrëveshjet

- 19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

Neni 20

Klauzolë mbyllëse

- 20.1 Ky Statut hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe me fuqi të njëjtë ligjore dhe pasi lexohet nga Ortaku i Vetëm themelues firmoset prej tij.

Tiranë, datë 07.08.2022

ALE ADVISERS shpk

Elton Gjipali